




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV VALI
Lindita Fazliu
Drejtoreshë
Gjilan



VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2021/33 - Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
TV VALI (Palë Përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 22 dhjetor 2017 ka miratuar Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerçiale Audiovizuale, me të cilën janë përcaktuar parimet themelore të komunikimeve komerciale audiovizuale gjatë emetimit të tyre nga ofruesit e shërbimeve mediale, duke përfshirë përmbajtjen, çështjet etike dhe kohëzgjatjen e komunikimeve komerciale audiovizuale.
2. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Rregulloren KPM-2017/07 ex officio ka iniciuar monitorimin e këtij subjekti. Bazuar në Raportin e monitorimit KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse me datën 3 dhe 4 shkurt 2021 ka transmetuar komunikime komerciale audiovizuale me përmbajtje të armëve. Në këto komunikime komerciale audiovizuale reklamohet pika e shitjes së armëve "Target", ku shfaqen lloje dhe marka të ndryshme të armëve që janë në shitje nga kjo kompani, si dhe poligoni i qitjes gjatë së cilës shfaqen persona duke shtirë me armë të ndryshme në poligon, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerçiale Audiovizuale.
3. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 5 shkurt 2021 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe e ka udhëzuar që të ofrojë sqarime brenda tre (3) ditësh lidhur me shkeljet e lartpërmendura.
4. KPM nuk ka pranuar përgjigje nga ana e Palës Përgjegjëse në lidhje me Njoftimin e dërguar.

Analiza ligjore

5. Përmes kësaj, Komisioni i Pavarur i Mediave konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 8, paragrafi 1, të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM 2017/07.
6. KPM, ka gjetur se Pala Përgjegjëse me datën 3 dhe 4 shkurt 2021 ka transmetuar komunikime komerciale audiovizuale me përmbajtje të armëve. Në këto komunikime komerciale audiovizuale reklamohet pika e slitjes së armëve "Target", ku shfaqen lloje dhe marka të ndryshme të armëve që janë në shitje nga kjo kompani, si dhe poligoni i qitjes gjatë së cilës shfaqen persona duke shtirë me armë të ndryshme në poligon, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale, i cili përcakton se:

"Të gjitha format e komunikimeve komerciale për cigare dhe produkte tjera duhani, armë dhe municion, pajisje piroteknike dhe droga janë të ndaluara."

7. Prandaj, KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 8, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale.

Vendim

8. Pala Përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, për shkelje të nenit 8, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale.

E drejta për ankesë

9. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
10. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



16.03.2021
Datë